REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJECIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE BASHKIA MALIQ

SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT ARTE

Nr. 90 prot Maliq, më 16.04.2025

PROJEKT VENDIM - NR. 8

PËR AKTIVITETIN KULTUROR 3 DITOR "SINEMANIA"

Në mbeshtetje të ligjit 139/2015 date 17.12.2015"Për vetëqeverisjen vendore " neni 54 "detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak, germa dh, neni 25 " Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese" , ligjit 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 32 " përgatitja dhe miratimi i Buxheteve vendore " ,të ligjit Nr 68/2018 "Per financat e vetëqeverisjes vendore" neni 45 "Rishpërndarjen e fondeve buxhetore", të ligjit Nr 115/2024"Për buxhetin e vitit 2025" , Udhëzimit plotësues nr 2 datë 24.01.2025"Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2025",mbështetur në vendimin Nr 4 datë 31.01.2025 të Këshillit Bashkiak Bashkia Maliq "Për miratimin e Buxhetit Shtesë për vitin 2025",", në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", ligjit nr. 25/2014 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën" dhe VKM nr.1173, datë 6.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e Qeverisjes Qëndrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", kërkojmë nga ana juaj :

1- Miratimin për mbështetje finaciare prej 399.557 (treqind e nëntëdhjet e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjet e shtatë) lek, aktivitetit artistik dhe kulturor « SINEMANIA », shaqje filmash dhe koncerte artistik me këngëtarë të njohur.
2- Preventivi i aktivitetit Kombëtar "Open Cinema" 2025 tre netë

   - Teknika e projeksionit ..... 170.000 lek
   - Paneli i Ekranit të filmit ..... 170.000 lek
   - Fonia..... 35.557 lek
   - Ndriçimi skenik..... 24.000 lek

3- Miratimin e datave të aktivitetit 29,30dhe 31 Korrik 2025.
4- Marëveshja për realizimin e aktivitetit do të bëhet midis Bashkisë Maliq dhe operatorit « Sinemania ».

Financimi i Projektit do të përballohet nga buxheti I Sektorit të Trashëgimisë Kulturore Turizmit dhe Arte.

PËRGJEGJËSI	DREJTORI	KRYETARI
Festim Tomorri	Rudina Bregu	Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr.504.Prot.

Tiranë, 04/09/2025

Z. Gëzim Topçiu, Kryetar i Bashkisë Maliq.
Në vemëndje të drejtorit të kulturës z.Festim Tomori.

Zhvillimi i aktivitetit Kombëtar "Open Cinema" (Kinemaja shëtitëse nëpër shqipëri), Filma, muzikë, argëtim.)

Ashtu si në shumë qytete të shqipërisë, edhe në qytetin tuaj Maliq, do të organizohet për gjatë këtij sezoni veror turistik, në datat 29-30-31 Korrik, aktiviteti Kombëtar: "OPEN CINEMA" edicioni i 9-të. Një panel me një skenë plotë ndriçim dhe audio profesionale, ekran i madh 60m2 i cili do të vendoset në sheshin e pedonales suaj, do të projektohen Premierat e fundit të kinemasë shqiptare si dhe asaj botërore. Këngëtar të njohur, Artistë, Kineastë të ftuar do të jenë pjesë e këtij show artistik – kinematografik.

Aktiviteti do të filloj çdo mbrëmje në orën 8:00 dhe do të mbaroj në orën 24:00.
Në 3 netë rresht, një show plot atmosferë do të sjelli kënaqësi të veçantë për pushuesit, vizitor e turistët të huaj në një argëtim

kulturor i cili tani është prezent në të gjithë teritorin e shqipërisë.

Ai do të drejtohet nga një marketing i fuqishëm duke qënë në vemëndje të medias së shkruar dhe asaj vizive si dhe nëpër rrjetet e ndryshme sociale. Qyteti juaj Maliqi, do të ketë një promovim duke qënë se spektakli do transmetohet edhe live.

Përmbledhje e projektit
(Përmbajtja shkurtimisht e projektit)

Ky projekt është menduar në formën e një spektakli show artistik - kinematografik që do të zgjasë 3 netë.

Në thelb të këtij do të jenë prodhimet e fundit të kinemasë shqiptare si dhe filmit të huaj të ri dhe nostalgjik. Gjithashtu dhe këngëtarë të njohur të cilët do të performojnë para ekranit në një skenë plot ndriçim. Ky aktivitet përcjell nga njeri brez tek tjetri, këtë gjini të bukur të artit të 7-të si dhe këngës të bukur shqiptare.

Është menduar që dhe fëmijët e vegjël të shijojnë ëndrrën e tyre nëpërmjet filmit të animuar shqiptar që ne do t'ju ofrojmë në ekranin e madh. Gjithashtu ne u ofrojmë në ekranin e madh dhe shfaqen e ndryshimeve që ka pësuar Qyteti i Maliqit ndërvite.
Një kënaqësi do të sjellë për publikun e gjerë dhe shërbimi i pijeve freskuese që kompanitë do të ofrojnë nga Tirana, duke e kthyer këtë aktivitet në një festë të bukur për këngën dhe filmin shqiptar.
Për këtë produksion dhe sipërmarje të madhe, nga ana juaj kërkohet ta mbështesni këtë aktivitet Kombëtar në shumën 400.000 (katërqindmij lek) për 3 netë resht, kundrejt faturës tatimore lëshuar nga ana jonë për mirëmbajtjen e tij në tre netë Magjike si dhe akomodimin e artistëve nga Tirana.

Projekti **"Open Cinema" (Kinemaja shëtitëse nëpër shqipëri)**, ka marrë një mbështetje të gjerë dhe vlerësime pozitive nga

institucionet kulturore dhe media në Shqipëri. Ja disa nga reagimet kryesore:

Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, ka ofruar mbështetje dhe logjistike për të siguruar suksesin e këtij projekti.

Institucionet Kulturore:
Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe Arkivi Shtetëror i Filmit kanë qenë mbështetës të mëdhenj të këtij projekti. Ata kanë kontribuar me fondin e tyre të filmave dhe na kanë ndihmuar në organizimin e shfaqjeve në qytete të ndryshme.

Shtypi i shkruar dhe televizionet i kanë bër jehonë duke e pasqyruar në kronikat e tyre kulturore dhe gazetat e ndryshme.

Aktviteti do të zhvillohet në muajin Korrik dt 29-30-31.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

Shtëpia filmike "Production Cinemania"

Producenti

Skënder Jaçe

Realizuese e veprave kinematografike & Paisje salla kinemaje

Rr.Himë Kolli, Tiranë, tel.0675629285, 0684115004

E-Mail cinek_roshi@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE BASHKIA MALIQ

SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE TURIZMIT ARTIT

Nr. 91 prot Maliq, më 14.04.2025

Relacion shpjegues për aktivitetin Kulturor dhe Artistik "OPEN CINEMA "

Për të pasur një larmi aktivitetesh dhe për të sjellë një risi në aktivitetet verore që organizon Bashkia Maliq ,si dhe për t'i shtuar kënaqësitë artistike në shërbim të komunitetit , në qytetin e Maliqit, për herë të dytë, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë z. Gëzim Topçiu, do të organizohet në datat 29,30 dhe 31 Korrik 2025, aktiviteti Kombëtar: "OPEN CINEMA".

Një ekran i madh 40m2 i cili vendoset në Shëtitoren e Bulevardit "RINIA" të qytetit, ku do të projektohen Premierat e fundit të kinemasë shqiptare si dhe asaj botërore. Këngëtarë të njohur, Artistë, Kineastë, të ftuar do të jenë pjesë e këtij show artistik – kinematografik.
Aktiviteti do të filloj çdo mbrëmje në orën 8:00 dhe do të mbaroj në orën 12:00.
Në 3 netë rresht, një show plot atmosferë do të sjelli kënaqësi të veçantë për publikun jo vetëm të Maliqit por edhe të zonës për rreth dhe më gjerë.

Është përzgjedhur ky projekt nga ana jonë me të vetmen arsye,se kemi menduar që ekrani i madh i kinemasë aq i munguar në vite, të jetë prezent edhe në qytetin e Maliqit,me prodhimet e fundit të kinemasë shqiptare dhe asaj botërore, si dhe muzikalitetin e bukur të këngës shqiptare e cila do të performohet nga këngëtarët të njohur kombëtarë. Në thelb të këtij do të jenë Prodhimet e fundit të kinemasë shqiptare si dhe filmit të huaj të ri dhe nostalgjik. Gjithashtu dhe këngëtarë të njohur të cilët do të performojnë para ekranit. Ky aktivitet përcjell nga njeri brez tek tjetri, këtë gjini të bukur të artit të 7-të si dhe këngës të bukur shqiptare

Qëllimi është për pasur një aktivitet të shtuar në jetën kulturore të Bashkisë dhe më gjerë në netët e nxehta të verës, në këtë zhanër të bukur siç është kinemaja aq e munguar në vite.

Objektivi kryesor i këtij projekti është që të përfitojmë për 3 netë me radhë një spektakël artistik-kinematografik duke ruajtur vlerat më të mira të këngës dhe kinemasë shqiptare si dhe dhe asaj botërore.

Përfituesi kryesor do të jetë komuniteti i Bashkisë, si dhe grupmoshat e ndryshme të Maliqit ku do të zhvillohet ky aktivitet kombëtar. Është menduar që dhe fëmijët e vegjël të shijojnë ëndrrën e tyre nëpërmjet filmit të animuar shqiptar që do të ofrohet në ekranin e madh. Gjithashtu është menduar të shfaqet dhe një retrospektivë nga arkivat e kohës që kemi në Arkivin Shtetëror të filmit për Maliqin në vite. I gjithë aktiviteti do të jetë falas për qytetarët e bashkisë.

Shpreh bindjen, se ky aktivitet, në këtë sezon turistik veror do të gjallëroj jetën kulturore të Bashkisë Maliqit.

FALEMINDERIT !

Konceptoi: F.Tomori ____/___/2025

DREJTORI I AGJENCISE

Rudina BREGU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
BASHKIA MALIQ